



Nr. 25 prot
DA. 31/05/2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 20 , datë 20.05.2022

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIMIN E LEJES
“KËRKESË PËR RINOVIMIN E KUSHTEVE TË
LEJES/AUTORIZIMIT”, SHOQËRISË “AFRIMI K” SH.P.K.

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së

Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim energjie elektrike me Nr.98 prot., datë 08.05.2017 miratuar nga KBU Drin-Bunë me Vendim Nr.17, datë 27.04.2017 “HEC Thanza”, subjektit “Afrimi K” sh.p.k., me vendndodhje, përroi i Kalimashit, Njësia Administrative Kalimash, Bashkia Kukës, Qarku Kukës, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor (përroi i Kalimashit)

HEC Thanza

Vepra e marrjes, koordinatat në KRGJSH

- X= 52 56 52.4
- Y= 46 57 049.8
- Z= 566 m.m.n.d

Godina e Centralit

Pika e shkarkimit, koordinatat në KRGJSH

- X= 52 67 43.74
- Y= 46 61 094.06
- Z= 299 m.m.n.d
- $Q_{mes}=0.64 \text{ m}^3/\text{s}$
- $Q_{llog}=0.9 \text{ m}^3/\text{s}$
- $Q_{eko}=0.06 \text{ m}^3/\text{s}$
- Fuqia max e instaluar N= 2000 kW

3. Zbatimi i lejes nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

